

32001R0068

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 68/2001, datë 12 janar 2001, mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së të ndihmës për trajnim

Gazeta Zyrtare L 010, 13/01/2001 fq. 0020 – 0029

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 68/2001, datë 12 janar 2001, mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së të ndihmës për trajnim

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 994/98 datë 7 maj 1998, mbi zbatimin e neneve 92 dhe 93 të Traktatit Themelues të Komunitetit European, mbi disa lloje të caktuara të ndihmës shtetërore horizontale [1], dhe në veçanti germa (a) nënpika (iv) e nenit 1 pika 1 të saj,

Pasi publikoi një projekt të kësaj rregulloreje [2],

Pasi u konsultua me Komitetin Këshillimor për Ndhmën Shtetërore,

Duke pasur parasysh se:

(1) Rregullorja (KE) nr. 994/98 e autorizon Komisionin të deklarojë, në përputhje me nenin 87 të Traktatit që, në kushte të caktuara, ndihma për trajnim është në përputhje me tregun e përbashkët dhe nuk i nënshtrohet kërkesës për njoftim të nenit 88 pika 3 të Traktatit.

(2) Komisioni, në disa vendime, ka zbatuar nenet 87 dhe 88 të Traktatit të ndihmës për trajnim dhe, së fundi, ka shpallur edhe politikën e tij në kuadrin ligjor e ndihmës për trajnimin [3]. Duke marrë parasysh përvojën e konsiderueshme të Komisionit, për zbatimin e neneve të ndihmës për trajnim, me qëllim që të sigurohet një mbikëqyrje efikase dhe të thjeshtohet administrimi, pa dobësuar kontrollin e Komisionit, duhet që Komisioni të përdorë fuqinë që i është dhënë nga Rregullorja (KE) nr. 994/98.

(3) Me qëllim që të krijohet një politikë transparente dhe koherente për të gjithë sektorët, shihet e përshtatshme që fusha e zbatimit e kësaj rregulloreje të jetë sa më i gjerë dhe të përfshijë sektorin bujqësor, peshkimin dhe akuakulturën.

(4) Kjo rregullore nuk ju heq të drejtën Shteteve Anëtare për të njoftuar ndihmën e trajnimit. Këto njoftime vlerësohen nga Komisioni, veçanërisht, duke marrë parasysh kushtet e dhëna në këtë rregullore, ose në përputhje me udhëzimet dhe kuadret ligjore të zbatueshme të Komunitetit, nëse ekzistojnë udhëzime dhe kuadret të tilla ligjore. Aktualisht, ky është rasti i veprimtarive që lidhen me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të listuar në Shtojcën I të Traktatit, dhe për sektorin e transportit detar. Kuadri ligjor për ndihmën për trajnim duhet të shfuqizohet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pasi përmbajtja e tij zëvendësohet nga kjo rregullore.

(5) Për arsye transparence, duhet theksuar se, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 51 pika 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1257/1999, datë 17 maj 1999, për mbështetjen e zhvillimit rural prej Fondi European i Garancisë dhe Orientimit të Bujqësisë (FEGOB) dhe amendimet e shfuqizimet e disa rregulloreve [4], nenet 87 deri 89 të Traktatit nuk zbatohen për kontributet financiare të ofruara nga Shtetet Anëtare për masat që synojnë mbështetjen komunitare për trajnimin sipas nenit 9 të rregullores në fjalë.

(6) Për arsye transparence, duhet nënvizuar se kjo rregullore zbatohet vetëm për masat e trajnimit, që përbëjnë ndihmë shtetërore sipas kuptimit të nenit 87 pika 1 të Traktatit. Shumë masa trajnuese nuk mbulohen nga ky nen, por përbëjnë masa të përgjithshme, sepse ato janë të hapura për të gjitha ndërmarrjet në të gjithë

sektorët, pa diskriminim dhe pa kompetenca vendimmarrje të autoriteteve që zbatojnë këto masa. Të tilla janë skemat e përgjithshme të nxitjes së taksave, si: kreditimi automatik i taksave, i hapur për të gjitha firmat që investojnë në trajnimin e punonjësve. Masat e tjera trajnuese nuk bien në fushën e zbatimit të nenit 87 pika 1 të Traktatit, sepse ato krijojnë një përfitim të drejtpërdrejtë për njerëzit kudo, dhe nuk krijojnë një përparësi për ndërmarrje ose sektorë të caktuar. Shembuj janë: shkollimi dhe trajnimi fillestar (të tilla si: stazhi i punës dhe skemat e ditës së lirimit); trajnimi ose ritrajnimi i njerëzve të papunë, përfshirë trajnimin në ndërmarrje; masat që synojnë drejtpërdrejtë punonjësit ose madje edhe disa kategori punonjësish, duke iu ofruar atyre mundësinë që të trajnohen për diçka që nuk ka lidhje me firmën apo industrinë ku ata punojnë. Në anën tjetër, duhet mbajtur parasysh që kontributet nga fondet sektoriale, nëse ato janë bërë të detyrueshme nga shteti, nuk konsiderohen si një burim privat, por përbëjnë burime shtetërore sipas kuptimit të nenit 87 pika 1 të Traktatit.

(7) Kjo rregullore duhet të përjashtojë nga njoftimi ndihmat individuale që përmbushin të gjitha kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe çdo skemë ndihme, duke u siguruar që çdo ndihmë e veçantë që mund të jepet në bazë të skemës përmbush të gjitha kërkesat e kësaj rregulloreje. Në këndvështrimin e sigurimit të një mbikëqyrje efikase dhe thjeshtëzimit të administrimit pa dobësuar kontrollin e Komisionit, skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale jashtë ndonjë skeme ndihme, duhet të përmbajnë një referencë të saktë të kësaj rregulloreje.

(8) Me qëllim që të eliminohen diferencat që mund të çojnë në shtrembërimin e konkurrencës, për të lehtësuar bashkërendimin ndërmjet nismave të ndryshme komunitare dhe kombëtare, në lidhje me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe për arsye të qartësisë administrative, përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme i përdorur në këtë rregullore është ai i dhënë në Rekomandimin e Komisionit 96/280/KE datë 3 prill 1996 [5].

(9) Me qëllim që të përcaktohet, nëse ndihma është apo jo në përputhje me tregun e përbashkët sipas kësaj rregulloreje, është e nevojshme që të merret në konsideratë intensiteti i ndihmës dhe, në këtë mënyrë, edhe vlera e ndihmës e shprehur si një grant i barasvlefshëm. Llogaritja e grantit të barasvlefshëm të ndihmës për t'u paguar në disa këste, dhe llogaritja e ndihmës në formën e një kredie të zbutur kërkojnë përdorimin e normave të interesit të tregut, që mbizotërojnë në momentin e dhënies së grantit. Për një zbatim të thjeshtë, transparent dhe uniform të rregullave të ndihmës shtetërore, normat e tregut për qëllimin e kësaj rregulloreje mendohen se janë normat e referencës, duke u siguruar që, në kushtet e një kredie të zbutur, kredia mbështetet nga siguri normale dhe nuk përfshin risk jonormal. Normat e referencës janë ato të cilat vendosen periodikisht nga Komisioni mbi bazën e kushteve objektive dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Europian dhe në internet.

(10) Zakonisht trajnimi ka efekte të jashtme pozitive për shoqërinë në tërësi, përderisa ai rrit numrin e punonjësve të aftë, nga të cilët mund të përfitojnë edhe ndërmarrjet e tjera, përmirëson konkurrueshmërinë e industrisë komunitare dhe luan një rol të rëndësishëm në strategjinë e punësimit. Në këndvështrimin e faktit se, përgjithësisht, ndërmarrjet në Komunitet investojnë për trajnimin e punonjësve të tyre, shteti mund t'i ndihmojë të korrigjojë këtë mangësi të tregut dhe, në këtë mënyrë, mund të konsiderohet që në kushte të caktuara kjo mbështetje të jetë në përputhje me tregun e përbashkët dhe si e tillë të përjashtohet nga njoftimi paraprak.

(11) Me qëllim që të sigurohet se ndihma shtetërore është e kufizuar në minimumin e nevojshëm për të ruajtur qëllimin e Komunitetit, të cilin vetë forcat e tregut nuk e kanë të mundur, intensitetet e lejueshme të ndihmës së përjashtuar duhet të rregullohen në përputhje me llojin e trajnimit të ofruar, madhësinë e ndërmarrjes dhe vendndodhjen e saj gjeografike.

(12) Trajnimi i përgjithshëm ofron kualifikime të transferueshme dhe përmirëson, kryesisht, aftësinë për të gjetur punë për punonjësit e trajnuar. Ndhma për këtë qëllim ka më pak efekte shtrembëruese mbi konkurrencën, kështu që intensitete më të larta të ndihmës mund të konsiderohen në përputhje me tregun e përbashkët dhe, në këtë mënyrë, të përjashtohen nga njoftimi paraprak. Nga ana tjetër, trajnimi specifik i cili, kryesisht, krijon përfitime për ndërmarrjen përfshin një risk më të madh të shtrembërimit të konkurrencës kështu që intensiteti i ndihmës, që mund të konsiderohet në përputhje dhe i përjashtuar nga njoftimi paraprak, duhet të jetë shumë më i vogël.

(13) Nga pikëpamja e mangësive me të cilat përballen NVM-të dhe kostot relativisht të larta që ato duhet të përballojnë kur ato investojnë në trajnimin e punonjësve të tyre, intensitetet e ndihmës së përjashtuar nga kjo rregullore duhet të rriten për NVM-të.

(14) Në zonat e mbështetura sipas nenit 87 pika 3 germa (a) dhe (c) të Traktatit, trajtimi ka një ndikim të jashtëm relativisht më të lartë, përderisa, në ato zona, ekziston një nëninvestim i konsiderueshëm në trajnim dhe një normë më e lartë papunësie. Si rrjedhim, për këto zona, duhet të rriten intensitetet e ndihmës së përjashtuar nga kjo rregullore.

(15) Karakteristika e trajnimit në sektorin e transportit detar justifikojnë një trajtim të veçantë për këtë sektor.

(16) Është me vend që vlerat e mëdha të ndihmës mbeten subjekt i një vlerësimi individual nga Komisioni përpara se ato hyjnë në fuqi. Prandaj, vlerat e ndihmës që kalojnë një vlerë të caktuar, e cila duhet të jetë tek 1000000 Euro, janë përjashtuar nga përjashtimi i siguruar në rregullore dhe mbeten subjekt i kërkesave të nenit 88 pika 3 të Traktatit.

(17) Kjo rregullore nuk përjashton ndihmën e akumuluar me ndihmën tjetër shtetërore, përfshirë ndihmën e dhënë nga autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, ose me asistencën komunitare, në lidhje me të njëjtat kosto të pranueshme, kur një akumulim i tillë kalon kufijtë e vendosur në rregullore.

(18) Me qëllim që të sigurohet transparenca dhe monitorimi i efektshëm në përputhje me nenin 3 të Rregullores (KE) nr. 994/98, është e nevojshme të krijohet një format standard, me të cilin Shtetet Anëtare sigurojnë për Komisionin një përmbledhje të informacionit në të gjitha ato raste, kur sipas kësaj rregulloreje, zbatohet një skemë ndihme ose është dhënë një ndihmë individuale jashtë skemave të tilla. Kjo është e domosdoshme për të mundësuar publikimin në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European. Për të njëjtat arsye, është e nevojshme të krijohen rregulla në lidhje me regjistrimet që Shtetet Anëtare duhet të mbajnë për sa i përket ndihmës së përjashtuar nga kjo rregullore. Me qëllimin që raportet vjetore të paraqiten pranë Komisionit nga Shtetet Anëtare, është e nevojshme që Komisioni të vendosë kërkesat e tij specifike, përfshirë informacionin në formë të kompjuterizuar, duke pasur parasysh disponueshmërinë e madhe të teknologjisë së nevojshme.

(19) Duke pasur parasysh përvojën e Komisionit dhe, në veçanti, shpeshtësinë me të cilën duhet të rishikohet politika e ndihmës shtetërore, është e nevojshme të kufizohet periudha e zbatimit të kësaj rregulloreje. Nëse Rregullorja shfuqizohet pa u zgatur afati i saj, skemat e ndihmës që janë të përjashtuara nga kjo rregullore do të vazhdojnë të jenë të përjashtuara edhe për gjashtë muaj.

KA MIRATUAR KËTË RRREGULLORE:

Neni 1

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për ndihmën, në të gjithë sektorët, përfshirë veprimtaritë e lidhura me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të renditura në Shtojcën I të Traktatit.

Neni 2 Përkufizime

Në këtë rregullore:

- a) “ndihmë” nënkupton çdo masë që përmbush të gjitha kushtet e dhëna në nenin 87 pika 1 të Traktatit;
- b) “ndërmarrje të vogla dhe të mesme” nënkupton ato ndërmarrje që janë përcaktuar në Shtojcën I;
- c) “ndërmarrje të mëdha” nënkupton ndërmarrjet që nuk përfshihen në përkufizimin e NVM-ve në Shtojcën I;
- d) “trajnimi specifik” nënkupton trajnimin që përfshin shkollimin e drejtpërdrejtë dhe në parim të zbatueshëm për punonjësit ekzistues ose vendet e ardhshme të punës në ndërmarrjet e ndihmuara, dhe që siguron kualifikime, të cilat nuk janë të transferueshme ose janë shumë pak të transferueshme tek ndërmarrjet ose sektorët e tjerë;
- e) “trajnim i përgjithshëm” nënkupton trajnimi që përfshin shkollimin që nuk është i zbatueshëm vetëm ose kryesisht për punonjësit ekzistues dhe për vendet e ardhshme të punës në ndërmarrjet e ndihmuara, por që siguron kualifikime që janë shumë të transferueshme tek ndërmarrjet ose sektorët e tjerë dhe, në këtë mënyrë, përmirëson dukshëm mundësinë e punonjësve për të gjetur punë. Trajnimi konsiderohet “i përgjithshëm” nëse, për shembull:
- i) ai është i organizuar së bashku nga disa ndërmarrje të pavarura ose, nëse punonjësit në ndërmarrje të ndryshme mund të vetëtrajnohen,
 - ii) ai njihet, certifikohet ose vërtetohet nga autoritetet ose organet publike, ose nga organe apo institucione të tjera, të cilit një Shtet Anëtar ose Komuniteti i ka dhënë autoritetin e nevojshëm;
- f) “intensiteti i ndihmës” nënkupton vlera bruto e ndihmës e shprehur si një përqindje e kostove të pranueshme të projektit. Të gjitha shifrat e përdorura duhen marrë përpara zbritjes së taksave të drejtpërdrejta. Kur ndihma nuk është dhënë në formën e grantit, atëherë vlera e ndihmës është granti i barasvlefshëm i ndihmës. Ndihma e paguar në disa këste zbritet në vlerën e saj në momentin e dhënies. Norma e interesit që përdoret për zbritjen dhe për llogaritjen e vlerës së ndihmës në një kredi të butë është norma referencë e përdorur në momentin e dhënies;
- g) “punonjës në vështirësi” nënkupton :
- çdo person i ri nën 25 vjeç, i cili më parë nuk ka pasur një punë të tij të parë, të paguar,
 - çdo person me paaftësi serioze të shkaktuar prej dëmtimeve fizike, mendore dhe psikologjike dhe që nuk është ende i aftë të hyjë në tregun e punës,
 - çdo punonjës emigrant, që lëviz ose ka lëvizur brenda Komunitetit për të punuar ose bëhet rezident në Bashkim dhe që ka nevojë për trajnim profesional dhe/ose gjuhësor,
 - çdo person që dëshiron të rifutet në punë pas një pushimi prej të paktën tre vjetësh dhe, veçanërisht, çdo person që lë punën për shkak të vështirësive për ta mbajtur njëkohësisht punën dhe familjen, për gjashtë muajt e parë pas marrjes në punë,
 - çdo person më i madh se 45 vjeç që nuk ka arritur një kualifikim më të lartë se arsimit mesëm ose një të barasvlefshëm me të,
 - çdo person i papunë për një afat të gjatë p.sh. personat që kanë qenë pa punë për 12 muaj rresht, për gjashtë muajt e parë pas marrjes në punë.

Neni 3 Kushtet për përjashtim

1. Ndihma individuale jashtë skemave, që përmbush të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje, është në përputhje me tregun e përbashkët në kuptimin e nenit 87 pika 3 të Traktatit, dhe përjashtohet nga kërkesa për njoftim e nenit 88 pika 3 të Traktatit, me kusht që ajo të përmbajë një referencë të qartë në këtë rregullore, duke cituar titullin e saj dhe referencën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European.

2. Skemat e ndihmës që përmbushin të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje janë në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe përjashtohen nga kërkesa për njoftim e nenit 88 pika 3 të Traktatit, me kusht që:
 - a) çdo ndihmë që mund të jepet sipas kësaj skeme të përmbushë të gjitha kushtet e rregullores;
 - b) skema të përmbajë një referencë të qartë në rregullore, duke cituar titullin e saj dhe referencën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Komisionit Europian.
3. Ndhima e dhënë sipas skemave të referuara në paragrafin 2 është në përputhje me tregun e përbashkët në kuptimin e nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe përjashtohet nga kërkesa për njoftim e nenit 88 pika 3 të Traktatit, me kusht që ndihma e dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë të përmbushë të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Ndhima për trajnim e përjashtuar

1. Skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale për trajnimin duhet të përmbushin kushtet e dhëna në paragrafët 2 deri në 7.
2. Kur ndihma është dhënë për trajnim specifik, intensiteti i saj nuk duhet të kalojë 25% për ndërmarrjet e mëdha dhe 35% për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
3. Këto intensitete rriten me pesë pikë përqindje për ndërmarrjet, në zonat që kualifikohen për ndihmë rajonale sipas nenit 87 pika 3 germa (c) të Traktatit, dhe me 10 pikë përqindje për ndërmarrjet në zonat që kualifikohen për ndihmë rajonale sipas nenit 87 pika 3 germa (a) të Traktatit.
4. Kur ndihma është dhënë për trajnim të përgjithshëm, intensiteti i saj nuk duhet të kalojë 50% për ndërmarrjet e mëdha dhe 70% për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
5. Këto intensitete rriten me pesë pikë përqindje për ndërmarrjet në zonat të cilat kualifikohen për ndihmë rajonale sipas nenit 87 pika 3 germa (c) të Traktatit dhe me 10 pikë përqindje për ndërmarrjet në zonat të cilat kualifikohen për ndihmë rajonale sipas nenit 87 pika 3 germa (a) të Traktatit.
6. Intensitetet maksimume të referuara në paragrafët 2 dhe 3 rriten me 10 pikë përqindje nëse trajnimi është bërë për punonjësit në vështirësi.
7. Në rastet kur projekti i ndihmës përfshin elemente si të trajnimit specifik ashtu edhe trajnimit të përgjithshëm, të cilët nuk mund të ndahen për llogaritjen e intensitetit të ndihmës, si dhe në rastet kur nuk mund të përcaktohet karakteri specifik ose i përgjithshëm i ndihmës për trajnim, intensitetet e zbatueshme janë ato të trajnimit specifik të paragrafit 2.
8. Kur ndihma është dhënë për sektorin e transportit detar ajo mund të arrijë një intensitet prej 100%, pavarësisht nëse projekti i trajnimit ka lidhje me trajnimin specifik apo të përgjithshëm, me kusht që të përmbushen kushtet në vazhdim:
 - i trajnuari nuk duhet të jetë një anëtar aktiv i ekuipazhit, por duhet të jetë i përkohshëm në bord, dhe
 - trajnimi duhet të realizohet në bordin e anijeve që janë regjistruar në regjistrat e Komunitetit.
9. Kostot e pranueshme të një projekti ndihme për trajnimin janë:
 - kostot personale të trajnuesve,
 - shpenzimet e udhëtimit të trajnuesve dhe të të trajnuarve,
 - shpenzime të tjera qarkulluese, të tilla si: materialet dhe furnizimet,
 - amortizimi i mjeteve dhe pajisjeve në masën që ato përdoren vetëm për projektin e trajnimit,
 - kostoja e udhëzimit dhe shërbimeve këshillimore që lidhen me projektin e trajnimit,

- kostot personale të të trajnuarve deri në vlerën e totalit të kostove të tjera të pranueshme, të referuara në (a) deri (e). Mund të llogariten vetëm orët gjatë të cilave të trajnuarit marrin pjesë në trajnim, pas zbritjes së ndonjë ore prodhuese ose të barasvlershmeve të tyre.

Kostot e pranueshme duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, të cilat duhet të jenë transparente dhe të specifikuara.

Neni 5

Grantet e mëdha të ndihmës individuale

Përrjashtimi nuk zbatohet nëse ndihma e dhënë për një ndërmarrje, për një projekt të vetëm trajnimi kalon vlerën prej 1000000 Euro.

Neni 6

Akumulimi

1. Kufijtë e ndihmës, të përcaktuar në nenet 4 dhe 5, zbatohen pavarësisht nëse mbështetja për projektin është financuar tërësisht nga burimet shtetërore ose është financuar pjesërisht nga Komuniteti.
2. Ndihma e përjashtuar nga kjo rregullore nuk i akumulohet ndonjë ndihme tjetër shtetërore në kuptim të nenit 87 pika 1 të Traktatit, ose me financime të tjera të komunitare, për të njëjtat kosto të pranueshme, nëse një akumulim i tillë çon në një intensitet ndihme që kalon atë të përcaktuar nga kjo rregullore.

Neni 7

Transparenca dhe monitorimi

1. Për zbatimin e një skeme ndihme ose dhënien e një ndihme individuale jashtë ndonjë skeme ndihme, të përjashtuar nga kjo rregullore, duhet që Shteti Anëtar brenda 20 ditëve pune, të dërgojë pranë Komisionit një përmbledhje të informacionit për skemën e ndihmës në fjalë ose ndihmën individuale, sipas modelit të dhënë në Shtojcën II, me qëllim që tek ai të publikohet në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European.
2. Shtetet Anëtare duhet të ruajnë të dhëna të detajuara në lidhje me skemat e ndihmës të përjashtuara nga kjo rregullore, ndihmat individuale të dhëna në bazë të skemave, si dhe të ndihmave individuale të përjashtuara nga kjo rregullore që janë dhënë jashtë çdo skeme ndihme ekzistuese. Të dhënat që ruhen duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të vërtetuar se kushtet për përjashtim janë përmbushur ashtu siç janë përcaktuar në këtë rregullore. Shtetet Anëtare duhet të ruajnë të dhënat për ndihmat individuale për një periudhë prej 10 vjetësh nga data në të cilën ajo është dhënë, dhe për një skemë ndihme 10 vjet nga data në të cilën është dhënë ndihma e fundit individuale në bazë të skemës. Komisioni mund të kërkojë me shkrim nga Shteti Anëtar në fjalë që, brenda 20 ditëve punë ose brenda një periudhe të përcaktuar në kërkesë, të sigurojë të gjithë informacionin, të cilin Komisioni e konsideron të nevojshëm për të vlerësuar nëse janë plotësuar kushtet e rregullores.
3. Shtetet Anëtare plotësojnë një raport, sipas formës së përcaktuar në Shtojcën III dhe në formë elektronike, për zbatimin e kësaj rregulloreje gjatë një viti të plotë kalendarik ose për pjesë të veçanta të tij, kur ka gjetur zbatim rregullorja. Shtetet Anëtare e paraqesin këtë raport pranë Komisionit jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të afatit, të cilin mbulon raportin.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë

1. Kjo rregullore hyn në fuqi njëzet ditë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Ajo mbetet në fuqi deri në 31 dhjetor 2006.

2. Në fund të periudhës së vlefshmërisë së rregullores, të gjitha skemat e përjashtuara në bazë të saj, mbeten të përjashtuara gjatë një periudhe përshtatjeje prej gjashtë muajsh.

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 12 janar 2001.

Për Komisionin

Mario Monti

Anëtar i Komisionit

[1] GZ L 142, 14.05.1998, fq. 1.

[2] GZ C 89, 28.03.2000, fq. 8.

[3] GZ C 343, 11.11.1998, fq. 10.

[4] GZ L 160, 26.06.1999, fq. 80.

[5] GZ L 107, 30.04.1996, fq. 4.

SHTOJCA I

Përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

(pjesë e shkëputur nga Rekomandimi i Komisionit nr. 96/280/KE, datë 3 prill 1996, në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (GZ L 107, 20.04.1996, fq. 4)

'Neni 1

1. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, referuar më poshtë si "NVM-të", përkufizohen si ndërmarrje që:

- kanë më pak se 250 të punësuar, dhe
- kanë ose, një xhiro vjetore që nuk kalon 40 milionë Euro, ose një bilanc vjetor që nuk kalon 27 milionë Euro,
- është në përputhje me kriterin e pavarësisë të shprehur në paragrafin 3.

2. Aty ku nevojitet të bëhet një dallim ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, "ndërmarrje e vogël" përkufizohet si një ndërmarrje që:

- ka më pak se 50 të punësuar dhe
- ka ose, një xhiro vjetore që nuk kalon 7 milionë Euro, ose një bilanc vjetor që nuk kalon 5 milionë Euro
-
- është në përputhje me kriterin e pavarësisë të shprehur në paragrafin 3.

3. Ndërmarrje të pavaruara janë ato, të cilat 25% ose më shumë e kapitalit ose e të drejtës së votës nuk zotërohen nga një ndërmarrje, ose bashkarisht nga disa ndërmarrje, që nuk përputhen me përkufizimet e një NVM-je ose një ndërmarrjeje të vogël, cilado të zbatohet. Ky prag mund të kalohet në dy rastet e mëposhtme:

- nëse ndërmarrja zotërohet nga korporata të investimeve publike, kompani me risk të lartë ose investues institucioni, me kusht që të mos ushtrohet kontroll mbi ndërmarrjen si individualisht ashtu edhe në grup,
- nëse kapitali është i shpërndarë në mënyrë të tillë që nuk është e mundur të përcaktohet se kush e zotëron ndërmarrjen dhe nëse kjo e fundit deklaron që mund të prezumojë ligjërisht që nuk zotërohet në 25% të saj ose më tepër nga një ndërmarrje, ose në bashkëpunim nga disa ndërmarrje, të cilat janë jashtë kuptimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ose ndërmarrjes së vogël, cilado qoftë e zbatueshme.

4. Në llogaritjen e pragjeve të përmendur në paragrafet 1 dhe 2, është e nevojshme të mblidhen statistikat përkatëse për ndërmarrjen përfituese dhe për të gjitha ndërmarrjet që kjo kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë duke zotëruar 25% ose më tepër të kapitalit ose të të drejtës së votës.

5. Aty ku nevojitet të dallohen mikrondërmarrjet nga ndërmarrje të vogla dhe të mesme të tjera, të parat përkufizohen si ndërmarrje që kanë më pak se 10 punonjës.

6. Nëse, në datën e bilancit të fundit, një ndërmarrje tejkalon ose bie nën pragun e numrit të punonjësve ose tavaneve financiare, kjo rezulton në fitimin ose humbjen e statusit si një "ndërmarrje e vogël dhe e mesme", "ndërmarrje e mesme", "ndërmarrje e vogël" ose "mikrondërmarrje" vetëm nëse ky fenomen përsëritet gjatë dy viteve financiarë të njëpasnjëshëm.

7. Numri i personave të punësuar përputhet me numrin vjetor të njësive punonjëse (AWU), që do të thotë, numrin e punonjësve të punësuar me kohë të plotë gjatë një viti me punonjësit me kohë të pjesshme dhe punonjësit sezonalë si një pjesë e vogël e AWU-së. Viti i referimit për vlerësim është ai i periudhës kontabël të miratuar të fundit.

8. Pragjet totale të xhiros dhe bilancit janë ato të periudhës kontabël 12 mujore të miratuara të fundit. Në rastin e ndërmarrjeve të reja llogaritë e të cilave nuk janë miratuar ende, pragjet që zbatohen duhet të rezultojnë nga një përlllogaritje e besueshme e kryer gjatë vitit financiar.'SHTOJCA II

Formulari i informacionit përmbledhës që duhet dhënë kurdo që të zbatohet një skemë ndihme që përjashtohet nga kjo rregullore dhe kurdo që një ndihmë individuale, e përjashtuar nga kjo rregullore, fitohet jashtë çdo skeme ndihme

Informacion përmbledhës për ndihmën shtetërore të dhënë në përputhje me Rregulloren e Komisionit (KE) 68/2001

Informacion përmbledhës për t'u plotësuar	Komente shpjeguese
Shteti Anëtar	
Rajoni	Jepni emrin e rajonit nëse ndihma jepet nga një autoritet joqendror
Titulli i skemës së ndihmës ose emri i shoqërisë tregtare që përfiton ndihmë individuale	Jepni emrin e skemës së ndihmës ose, në rastin e ndihmës individuale, emrin e përfituesit Në rastin e dytë, nuk nevojitet raporti vjetor pasardhës!
Baza ligjore	Jepni referencën e saktë ligjore kombëtare për skemën e ndihmës ose ndihmën individuale
Shpenzimet vjetore të planifikuara sipas skemës ose shuma totale e ndihmës individuale që i jepet shoqërisë tregtare	Shumat duhet të jepen në Euro ose, nëse është e zbatueshme, në valutën kombëtare. Në rastin e një skeme ndihme: jepni shumën totale vjetore të fondit të miratuar në buxhet ose humbjen fiskale të përlllogaritur në vit për të gjitha instrumentat e ndihmës që janë pjesë e skemës. Në rastin e ndihmës individuale: Jepni shumën totale të ndihmës/humbjen fiskale. Nëse duhet, jepni gjithashtu për sa vjet do të paguhet ndihma në këste ose në sa vjet do të pësohet humbje fiskale. Për garanci në të dy rastet, jepni shumën (maksimale) të huave të garantuara
Intensiteti maksimal i ndihmës	Jepni intensitetin maksimal të ndihmës ose shumën maksimale të ndihmës për çdo artikull të vlefshëm
Data e zbatimit	Jepni datën në të cilën mund të jepet ndihma

	sipas skemës ose ndihma individuale
Kohëzgjatja e skemës ose ndihmës individuale	Jepni datën (vitin dhe muajin) deri në të cilën ndihma mund të jepet sipas skemës ose në rastin e ndihmës individuale dhe, nëse duhet, datën e planifikuar (viti dhe muaji) të pagesës së kështit të fundit
Qëllimi i ndihmës	Në rastin e ndihmës për trajnim, jepni nëse trajnimi është i përgjithshëm ose specifik.

Informacion përmblledhës për t'u plotësuar	Komente shpjeguese
Sektori/sectorët ekonomikë të përfshirë <input type="checkbox"/> Të gjithë sektorët Ose <input type="checkbox"/> Bujqësia <input type="checkbox"/> Peshkimi dhe Akuakultura <input type="checkbox"/> Nxjerrja e qymyrgurit <input type="checkbox"/> E gjithë industria e prodhimit Ose <input type="checkbox"/> Çeliku <input type="checkbox"/> Ndërtimi i anijeve <input type="checkbox"/> Fibrat sintetike <input type="checkbox"/> Automjetet <input type="checkbox"/> Prodhim tjetër <input type="checkbox"/> Të gjitha shërbimet Ose <input type="checkbox"/> Shërbime të transportit detar <input type="checkbox"/> Shërbime të tjera transporti <input type="checkbox"/> Shërbime financiare <input type="checkbox"/> Shërbime të tjera Komente:	Zgjidhni nga lista, sipas rastit
Emri dhe adresa e autoritetit dhënës të ndihmës	
Informacion shtesë	

-SHTOJCA III

Formulari i raportit periodik që i mundësohet Komisionit

Formati i raportimit vjetor për skemat e ndihmës të përjashtuara sipas një rregulloreje përjashtuese në grup të miratuar në zbatim të nenit 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 994/98

Shtetet Anëtare janë të detyruar të përdorin formatin e mëposhtëm për detyrimet e tyre raportuese drejtuar Komisionit sipas rregulloreve përjashtuese në grup të miratuara në bazë të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 994/98

Raportet duhet të mundësohen gjithashtu në formë elektronike.

Informacioni i nevojshëm për të gjitha skemat e ndihmës të përjashtuara sipas rregulloreve përjashtuese në grup të miratuara në zbatim të nenit 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 994/98

1. Titulli i skemës së ndihmës

2. Rregullorja përjashtuese e Komisionit e zbatueshme

3. Shpenzime

Statistika të veçanta duhet të mundësohen për çdo instrument të ndihmës brenda një skeme ose ndihme individuale (p.sh. grante, hua të buta, etj.). Statistikat duhet të shprehen në Euro ose, nëse është e zbatueshme, në valutën kombëtare. Në rastin e shpenzimeve fiskale, duhet të raportohen humbjet fiskale vjetore. Nëse nuk disponohen statistika të sakta, humbje të tilla mund të përlllogariten afërsisht.

Statistikat e shpenzimeve duhet të mundësohen sipas kushteve të mëposhtme:

Për vitin nën shqyrtim jepni të ndara për secilin instrument brenda skemës së ndihmës (p.sh. grante, hua të buta, garanci, etj.):

3.1. shumat e angazhuara, (me përlllogaritje) humbjet fiskale ose të ardhura të tjera të humbura, të dhëna për garancitë, etj. për projekte të reja me mbështetje. Në rastin e skemave të garancisë, duhet të mundësohet shuma totale e garancive të reja të shpërndara.

3.2. pagesat aktuale, (me përlllogaritje) humbjet fiskale ose të ardhura të tjera të humbura, të dhëna për garancitë, etj. për projekte të reja dhe aktuale. Në rastin e skemave të garancisë, duhet të mundësohen si vijon: shuma totale e garancive të papaguara, e ardhura prim, rikthimet, dëmshpërblimet e rimbursuara, rezultati operativ i skemës sipas vitit nën shqyrtim;

3.3. numri i projekteve të reja me mbështetje;

3.4. numri total i përlllogaritur i punëve të krijuara ose të mbajtura nga projektet e reja (nëse duhet);

3.5. shuma totale e përlllogaritur e investimeve të ndihmuara nga projektet e reja

3.6. ndarja rajonale e shumave sipas pikës 3.1 ose sipas rajoneve të përkufizuara në nivelin e dytë të NNJTS-së [1] ose më ulët ose rajoneve sipas nenit 87 pika 3 gërma (a), rajoneve sipas nenit 87 pika 3 gërma (c) dhe rajonet e pambështetura;

3.7. ndarja e shumave sipas sektorëve sipas pikës 3.1 në sektorë aktiviteti të përfituesve (nëse mbulohet më shumë se një sektor, jepni pjesën e secilit):

- bujqësia
- peshkimi dhe/ose akuakultura
- nxjerrja e qymyrgurit
- industria e prodhimit

Nga e cila:

- çeliku
- ndërtimi i anijeve
- fibrat sintetike
- mjetet motorike
- prodhim tjetër (ju lutem saktësoni)
- shërbime

Nga të cilat:

- shërbime të transportit detar
- shërbime të tjera transporti
- shërbime financiare
- shërbime të tjera (ju lutem saktësoni)
- sektorë të tjerë (ju lutem saktësoni)

4. Informacion shtesë dhe Komente

[1] NNJTS-ja është Nomenklatura e Njësive Territoriale për qëllime Statistike në BE.

